

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti për të Mitur, gjyqtarja Kymete Kicaj, me sekretaren juridike – procesmbajtësen Besnike Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. T. nga fsh. G., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale – marrëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së dhe veprës penale – lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragraf 1 nënparagraf 1.4 të KP-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.235/2016, të dt.24.10.2016, pas mbajtjes së seancës dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, në seancë jo publike me dt.31.10.2016, në prezencën e prokurorit të shtetit Arijana Shajkovci, zyrtarit nga Njësia për Mbrojtjen e Viktimave Ganimete Kitmir, të akuzuarit A. T. dhe mbrojtësit të tij av. E. G., mbrojtësit e të dëmtuarave av. H. C. dhe av. A. G., mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. T., nga i ati H. dhe e ëma N., e lindur Q., data e lindjes... në fshatin G.-Komuna e Prizrenit, me punë të përkohshme në shtetin e Gjermanisë, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, babai i tre fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në paraburgim, nga data 21.09.2016.

ËSHTË FAJTOR

I. Se nga muaji Maj i vitit 2016 në fshatin G.-Komuna e Prizrenit, si prind e ngacmon seksualisht të dëmtuarën – vajzën e tij A. T., data e lindjes..., në atë mënyrë që kur vie në fshatin G. për pushim nga Gjermania, ku i pandehuri është me punë dhe vendqëndrim, në muajin Maj së bashku me tre fëmijët e tij, shkojnë në mal për dru dhe me të arritur në mal derisa dy fëmijët tjerë kanë qenë duke grumbulluar dru më lartë në mal, në momentin kur ata largohen, kryen aktin seksual, duke e detyruar të zhveshet e dëmtuara, zhveshet edhe vet dhe organin e tij seksual e futë në gojën e viktimës, gjithashtu derisa ka qëndruar në shtëpi i ka detyruar të gjithë fëmijët të flenë në një dhomë dhe të dëmtuarën A. e merr afër tij e ngacmon seksualisht duke prekur në organet intime-gjoks dhe organin gjenital, veprime keto i përsëritë edhe me datën 21.09.2016 duke e kërcënuar kinse për të mësuar e detyron të dëmtuarën A. të mësoj, në dhomën e fjetjes të tyre, ku edhe vet bie në gjumë dhe rreth orës 03.00 kur e dëmtuara e zgjon babain (të pandehurin) duke treguar se i ka mësuar mësimet, i pandehuri zgjohet dhe derisa e dëmtuara A. ka qenë duke lexuar mësimin e dytë, ai fillon ta preki në pjesën e poshtme – organin gjenital derisa për shkak të dyshimit nga e dëmtuara M., e cila e përcjellë situatën duke e vëzhguar nga dera veprimet e bashkëshortit të saj dhe në momentin kur i vëren këto veprime të bashkëshortit reagon duke hyrë në dhomë dhe duke i thënë bashkëshortit, që ta lejoj A. të flejë, në çka i pandehuri reagon ashpër dhe e rrahë bashkëshorten M.

Me këtë kryen veprën penale – marëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së.

II. Se me datë 21.09.2016, në orët e mesnatës për shkak të rastit të ndodhur si në dispozitivin nën I, i shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarës – bashkëshortes M. T., në atë mënyrë që në momentin kur e dëmtuara reagon në rastin kur vëren se i pandehuri –bashkëshorti i saj është duke e ngacmuar seksualisht vajzën e tyre A., i pandehuri i drejtohet me sulm ndaj të njëjtës me ç’rast tek e dëmtuara shkakton lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin, më afër të përshkruar si në mendimin e ekspertit mjeko-ligjor Dr. D. H.

Me këtë kryen veprën penale – lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KP-së.

I.

Andaj gjykata duke vepruar konform nenit 41,42, 43, paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, 45,75 dhe 76 dhe nenin 83 të KP-së lidhur me nenin 365 të KPP-së, për veprën penale marëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së, të akuzuarit A. T., i shqipton:

DËNIMIN ME BURGIM

Në kohëzgjatje prej (4) katër viteve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dt.21.09.2016.

II.

Duke vepruar konform nenit 43 paragraf 1 pika 1.3 nenit 46 të KP-së, për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të KP, të akuzuarit Asllan Tejeci, i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Duke i’u caktuar të akuzuarit të paguaj shumën prej (200) dyqindë Euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë gjobën, gjykata do t’ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënimin me burgim, ashtu që do të llogaritet 20 Euro për një ditë burgim.

- E dëmtuara M. T., nga fsh. G., Komuna e Prizrenit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që kësaj gjykate t’ia paguaj të gjitha shpenzimet procedurale

dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (150) njëqindpesëdhjetë euro, të cilën shumë duhet ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP.nr.235/2016, të dt.24.10.2016, kundër të akuzuarit A. T. nga fsh. G., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale – marëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së dhe veprës penale – lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 paragraf 1 nënparagrafi 1.4 i KP-së dhe njëkohësisht gjykatës i ka parashtruar marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur në mes tyre dhe të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur seancën dëgjimore për shqyrtimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë PP.nr.235/2016 të dt.24.10.2016

Gjatë seancës dëgjimore së shqyrtimit të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata ka dëgjuar të akuzuarin, mbrojtësin e tij, përfaqësuesit e palëve të dëmtuara, si dhe prokuroren e shtetit.

Sa i përket gjendjes faktike konsiderohet se ajo është vërtetuar plotësisht si në përshkrimin faktik të aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit gjatë seancës dëgjimore ka deklaruar se nga provat e mbledhura gjatë fazës së hetimeve është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale – marëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së, dhe veprës penale – lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 paragraf 1 nënparagrafi 1.4 i KP-së. Andaj nisur nga provat të cilat janë siguruar dhe me qëllim të negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë, prokuroria ka informuar mbrojtësin e të akuzuarit av. E. G. dhe është mbajtur seanca me datën e cekur, në të cilën seancë janë parashtruar kushtet nga të dyja palët, ku prokuroria e ka njoftuar të akuzuarin se për veprën penale marëdhëniet seksuale brenda familjes, nga neni 243 paragraf 3 të KP-së, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi jo më pak se pesë vite burgim dhe për veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 paragraf 1 nënparagrafi 1.4 të KP-së, është paraparë dënimi me gjobë ose burgim deri në një vit dhe konform dispozitës ligjore të nenit 233 paragrafi 7 nënparagrafi 7.2 dhe nenit 76 të KPP-së, për këto dy vepra penale gjegjësisht për veprën e parë nga neni 243 paragrafi 3 të KP-së, është rekomanduar dënimi në kohëzgjatje prej 3 – 4 vite burgim dhe veprës së dytë penale, dënimi i rekomanduar të jetë dënimi me gjobë në shumën prej 200 (dyqindë) Euro të përcaktuar me ligj. I akuzuari dhe mbrojtësi i tij pas konsultimeve të nevojshme vullnetarisht ka hy në marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe se ky pranim mbështetet në faktet dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës.

I akuzuari A. T. gjatë seancës ka deklaruar se ka hy vullnetarisht në marrëveshje për pranimin e fajësisë duke qenë i vetëdijshëm plotësisht për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë të njëjtën e ka nënshkruar personalisht pas konsultimeve me mbrojtësin e tij.

Mbrojtësi i të akuzuarit A. T. – av. E. G. ka deklaruar se: ngel në tërësi si në marrëveshjen e arritur me shkrim ndërmjet të akuzuarit dhe PSH-së, duke shtuar se i akuzuari vullnetarisht ka hyrë në këtë marrëveshje.

Mbrojtësi i të dëmtuarës A. T. – av. H. C. ka deklaruar se në tërësi e mbështet marrëveshjen e arritur në mes të akuzuarit, mbrojtësit të tij dhe PSH-së, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ndërsa sa i përket kërkesës pasurore juridike në emër të të dëmtuarës ka deklaruar se nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Po ashtu edhe mbrojtësi i të dëmtuarës M. T. – av. A. G. ka deklaruar se: nuk e kundërshton marrëveshjen për pranimin e fajësisë të arritur dhe të nënshkruar nga palët, ndërsa për kërkesën pasurore juridike do të vendosin në fazat e tjera të procedurës.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, mbrojtësit të të dëmtuarës lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë konstatoi se i akuzuari A. T. ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë të pranoj fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuar edhe nga i akuzuari.

Gjatë seancës për caktimin e dënimit prokurori i shtetit Arijana Shajkovci ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë dënimit të rekomanduar si në marrëveshjen e arritur për pranimin e fajësisë të përshkruar si në pikën 3 të marrëveshjes së arritur. Ndërsa sa i përket masës së paraburgimit ka konsideruar se këtë çështje e lë në vlerësim të gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. E. G., rreth dënimit i cili është propozuar në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: ngelet në tërësi si në dënimin e rekomanduar në marrëveshje duke propozuar që gjykata të ketë parasysh minimumin e dënimit të rekomanduar në marrëveshje për pranimin e fajësisë. Ndërsa sa i përket masës së paraburgimit ka theksuar se duhet ti ndërpritet masa e paraburgimit duke pasur parasysh se kanë pushuar të gjitha kushtet ligjore për të cilat është caktuar kjo masë.

I akuzuari A. T. ka deklaruar se: në tërësi është pajtuar me dënimin e rekomanduar nga ana e prokurorit të shtetit.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptimin **nën I** dhe **II** të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit e më parë duke e vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i dëgjoi deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ashtu duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat të parapara nga neni 74 të KPP-së, të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Kështu që gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si nën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi do të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 41 të KP-së, dhe se dënimet e tilla të shqiptuara, sipas bindjes së gjykatës

janë në proporcion me peshën e veprave penale të kryera dhe me rrethanat personale të të akuzuarit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pronësoreshë juridike është marrë konform nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për të Mitur
PKR.nr.182/2016, të dt. 31.10.2016

Sekretare juridike,
Besnike Morina

Gjyqtarja
Kymete Kicaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite nga dita e praniminës së kësaj gjykate, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmjet të kësaj gjykate.